URDHËR
Nr. 172, datë 19.3.2026

PËR DELEGIMIN E AUTORITETIT/KOMPETENCAVE NËPUNËSVE TË LARTË CIVILË TË MINISTRISË SË DREJTËSISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës publike"; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; si dhe të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Drejtorit të përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse të Ministrisë së Drejtësisë, për plotësimin e detyrave funksionale, i delegohen kompetencat dhe autoriteti i titullarit të Ministrisë së Drejtësisë, lidhur me:

a) Lëshimin e autorizimeve për dërgimin me shërbim brenda vendit të punonjësve të aparatit të Ministrisë së Drejtësisë, në përputhje me nënndarjen "i", të shkronjës "a", të pikës 2, të kreut V, të vendimit nr. 997, datë 10.12.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit", të ndryshuar;

b) Ushtrimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor për zhvillimin e procedurave të prokurimit publik për blerjet me vlerë të vogël deri në 100.000 lekë pa TVSH;

c) Ushtrimin e kompetencave të titullarit të autoritetit shitës për Ministrinë e Drejtësisë, në zbatim të shkronjës "a", të pikës 5, të kreut V, të vendimit nr. 1719, datë 17.12.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave të ankandit publik", të ndryshuar.

2. Ngarkohet drejtori i përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse për zbatimin e këtij urdhri.

3. Ngarkohet Sektori i Arkiv-protokollit për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Toni Gogu